



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 18.6.2015,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shaip Shabani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Sokol Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Teuta Krasniqi (LVV), Blerand Stavileci (PDK) dhe Bardha Dida - Rogova (LVV).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillohej me rendin e ditës, **Imer Rusinovci**, në emër të GP të AAK-së, ngriti shqetësimin me rastin e arrestimit të padrejtë të z. Ramush Haradinaj, duke thënë se nuk kemi vullnet të jemi të pranishëm në mbledhje, për shkak të arrestimit të padrejtë të liderit të AAK-së në Slloveni. Njëherësh kërkoi nga niveli qendror që t'i shikojë më mirë këto çështje dhe t'i thuhet jo njëherë e përgjithmonë arrestimeve të padrejta.

Me shqetësimin e z. Rusinovci u solidarizuan edhe Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së dhe Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, duke iu bashkangjitur kërkesës së GP të AAK-së për apelin, që institucionet e Kosovës të marrin masa që z. Haradinaj të kthehet në vend.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi u solidarizua me kërkesën e z. Rusinovci, që z. Ramush Haradinaj të lirohet sa më shpejt dhe të kthehet në atdhe.

Lidhur me rendin e ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që pikat 3, 4 dhe 5, të hiqen prej rendit të ditës, sepse konsiderojmë që në mungesë të drejtorit dhe të Kryetarit, dhe për arsye të tjera që janë të njohura, nuk ia vlen të diskutohen më tutje për këto pika. Njëherësh propozoi që të shihet mundësia e gjetjes së dy hapësira - shesheve dhe të emërohen me emrat e veprimtarëve Adem Demaçi dhe Ukshin Hoti.

Kryesuesi konstatoi se në parim pajtohen me propozimin për emërtimin e dy shesheve me emrat e veprimtarëve Adem Demaçi dhe Ukshin Hoti, dhe mbetet që ekzekutivi të merret me caktimin e lokacioneve.

Për rendin e ditës dhe propozimin e dhënë nga z. Çelaj, diskutuan edhe Sami Hamiti, Ylli Hoxha, Qëndron Kastrati, Sadri Ramabaja, Islam Pacolli, Remzi Pacolli, Sylejman Pireva, Kreshnik Ahmeti, Feti Mehdiu dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me gjashtëmbëdhjetë (16) vota për dhe me njëzet e tri (23) vota kundër, (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Bekim Gashi, Naime Osmani, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Lirak Çelaj, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi dhe Shemsi Veseli), (sipas rendit të ditës të propozuar), hiqen pikat: *Propozimvendimi për miratim - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria; Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1" dhe Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë.*

Kryesuesi konstatoi se u miraua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;
2. Prezantimi i shkurtër lidhur me punën dhe aktivitetet e Kryqit të Kuq të Kosovës;
3. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
4. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;
5. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së;
6. Informatë për mbjelljet pranverore;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt.

Shemsi Veseli bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se në faqen katër (4) të ekstraktit, në votimin e pikës, mungon emri im, andaj kërkoj që kjo të korigjohet.

Lirijeta Rexhepi bëri vërejtje në ekstrakt, e cila tha se çështjen të cilën e kam ngritur rreth instalimit të gypave dhe projektit në lagjen "Velania", nuk është që ka ngecur me vite, por do të duhej të jetë: "*me muaj*". Kërkoj që kjo të korigjohet.

Me vërejtjet e dhëna, u konstatua se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt.

Pika e dytë

Prezantim i shkurtër lidhur me punën dhe aktivitetet e Kryqit të Kuq të Kosovës.

Lidhur me punën e Kryqit të Kuq të Kosovës, në pika të shkurtëra të pranishmit i informuan Feride Hyseni dhe Rajmonda Musliu, përfaqësuese të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Shefki Gashi kërkoj të dijë se çka është duke ndodhur me objektin e ndërtuar nga Kryqi i Kuq në fshatin Mramuer, dhe a është në projekt që ai objekt të shfrytëzohet për ndonjë destinacion të caktuar.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Gashi, **Feride Hyseni** dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi i falenderoi përfaqësueset e Kryqit të Kuq të Kosovës për prezantimin e punës dhe aktivitetëve të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, të pranishmit i informoi Dardan Sejdiu, nënkryetar.

Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, shprehu rezervë rreth këtij propozimvendimi, me ç'rast propozoi që kjo pikë të shtyhet për diskutim, me arsyetimin se për këtë çështje duhet të bisedohet edhe me banorët e fshatit Barilevë, dhe të verifikohet edhe një herë i gjithë dokumentacioni i pronës.

Për këtë propozimvendim diskutuan Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Flamur Shala, në emër të GP të LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik LB, Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP, Ylli Hoxha, Sami Hamiti, Lirak Çelaj, Abit Kastrati, Shefki Gashi, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Sylejman Pireva, Hatixhe Latifi - Pupovci, Shemsi Veseli dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, pas përfundimit të diskutimeve, e hodhi në votim Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Kryesuesi konstatoi se me katërbëdhjetë (14) vota për dhe njëzet (20) kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Bekim Gashi, Naime Osmani, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu dhe Besa Rafuna) dhe gjashtë (6) abstenime (Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi, Shaip Shabani, Shemsi Veseli, Lirije Avdiu dhe Remzi Pacolli), nuk u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, në pika të shkurtëra i njoftoi të pranishmit rreth propozimvendimit për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Për këtë propozimvendim diskutuan Flamur Shala, në emër të GP të LDK-së, Ylli Hoxha, në emër të GP të LVV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, Sadri Ramabaja, Laura Zherka, Kreshnik Ahmeti, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe Sylejman Pireva, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi pas përfundimit të diskutimeve, e hodhi në votim Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi konstatoi se me njëmbëdhjetë (11) vota për, tetëmbëdhjetë (18) vota kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Bekim Gashi, Naime Osmani, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu dhe Besa Rafuna) dhe 6 abstenime (Laura Zherka, Lirijeta Rexhepi, Shaip Shabani, Shemsi Veseli, Lirije Avdiu dhe Remzi Pacolli), nuk u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Pika e pestë

Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së.

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së, të pranishmit i informoi Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Për këtë propozimvendim diskutuan Agim Gashi, në emër të GP të LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Remzi Pacolli, shef i GP të AKR-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, Ylli Hoxha, Shemsi Veseli, Sadri Ramabaja, Visar Arifaj, Muhamet Selmani dhe Sami Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi pas përfundimit të diskutimeve, e hodhi në votim Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e tri (23) vota për, dy (2) vota kundër (Visar Arifaj dhe Shemsi Veseli) dhe tetë (8) abstenime (Kimet Zeqa, Feti Mehdiu, Muhamet Selmani, Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva, Shaip Shabani, Remzi Pacolli), u miratua Vendimi për vazhdimin e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim AUK-së.

Pika e gjashtë

Informatë për mbjelljet pranverore.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, i njoftoi të pranishmit rreth mbjelljeve pranverore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah informata për mbjelljet pranverore.

Pika e shtatë

Pyetje dhe përgjigje.

Agim Gashi, pyetje për Kryetarin e Komunës.

Në objektet e Komunës së Prishtinës, siç është objekti në rrugën “Luan Haradinaj”, pastaj në lagjen “Arbëria” dhe në objektet tjera, nuk shihet flamuri shtetëror i Kosovës mbi portat e objekteve.

Po ashtu, me rastin e shënimit të festave të ndryshme dhe ngjarjeve të rëndësishme, flamuri shtetëror vazhdon të mos përdoret nga qeveria komunale dhe shërbimet

përkatëse. Në bazë të kësaj, mund të themi se po bëhet shkelja e Ligjit për përdorimin e simboleve të shtetit të Kosovës.

Pyetja është se kur do të respektohet ky ligj nga organi kompetent i Komunës së Prishtinës. Përgjigjen dëshiroj ta kem me shkrim.

Mustafë Krasniqi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Një çështje që e kam ngritur edhe para 2-3 seancave tek drejtori i Infrastrukturës, rreth rrugës që është trajtuar para tri apo katër viteve, rruga për Grashticë, dhe që nga atëherë nuk është mirëmbajtur. Kohëve të fundit sigurisht që me reshjet e mëdha që kanë ndodhur, ka nevojë të mirëmbahet dhe të trajtohet. Ka rrëshqitje shumë të mëdha në trup të rrugës, mbyllje të kanaleve etj. prandaj edhe një herë kërkoj nga Drejtoria që të qetë kompaninë atje, ta bëjë pastrimin dhe mirëmbajtjen e asaj rruge, për shkak se është duke u dëmtuar me të madhe.

Njëherësh paraqiti shqetësimin e banorëve që janë përballë Kuvendit, të cilët kërkojnë të dinë pse nuk vjen si pikë e rendit të ditës, apo si shqetësim, të diskutohet rreth kërkesave dhe problemeve të tyre që kanë pasur.

Shaip Hajrizi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Në rrugën "Ismet Krasniqi", në lagjen "Kodra e Trimave", janë rrënuar muret e shtëpive për rregullimin e trotuarit. Është kërkesë e qytetarëve të kësaj lagjeje, që sa më parë të finalizohet ky projekt, sepse kanë mbetur shtëpitë pa mure, dhe kërkojnë që urgjentisht të intervenohet, në mënyrë që ato mure që janë rrënuar, të rregullohen ashtu si ka qenë marrëveshja në mes tyre dhe Komunës.

Bekim Gashi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastruktues Lokale.

Kur kanë filluar punimet në rrugën "Brigada 153" në Hajvali? Para një viti i kam sugjeruar drejtorit të drejtorisë përkatëse, se nuk duhet të fillohet rruga, se nuk është bërë shpronësimi i pronave, edhe sot e asaj dite nuk është filluar procesi i shpronësimit të pronave, kurse rruga është bërë e pakalueshme. D.m.th. një vit përpara, kur nënkryetari, së bashku me kryetarin dhe drejtorin e Infrastrukturës, kanë qenë në atë rrugë, ka qenë shumë më mirë sesa që është sot. Kërkoj një shpjegim se cila është arsyeja për ngecjen e punimeve në rrugën "Brigada 153" në Hajvali.

E dyta, ka të bëjë me rrugën e KFOR-it, që lidhet me Inspektoratin e Policisë. Tash e tri javë ditë është bërë shenja e një korsisë së rrugës dhe Komuna e Prishtinës i ka vendosur disa shenja të rrezikut, dhe ka mbetur ashtu. Do të thotë, mbrëmë shiu që ka rënë, e kam parë që ka vazhduar edhe pjesa tjetër e rrugës me u shembur dhe Komuna e Prishtinës nuk ka marr asnjë masë që të rregullohet ajo rrugë, në mënyrë që të bëhet më i lehtë kalimi i qytetarëve, edhe i lidhjes së Hajvalisë me qytetin e Prishtinës dhe Inspektoratin e Policisë, aty është edhe Pallati i Drejtësisë.

Pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Kërkojmë një raport nga kjo drejtori, që të na njoftojë se sa klube sportive Komuna e Prishtinës i ka subvencionuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015. Shpresoj që në seancën e ardhshme, t'i kemi këto përgjigje.

Sylejman Pireva

Të nderuar,

Firma e bibliotekës "Hivzi Sylejmani", e cila qëndron në dy vende, në murin e saj dhe në hyrje të trotuarit, para hyrjes atje, bie në kundërshtim me statusin e saj.

Deri në vitin 2008, ka qenë bibliotekë ndërkomunale, me status në Ministrinë e Kulturës. Nga viti 2008, është bibliotekë publike, në kuadër të Komunës, aty firma ekziston Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Biblioteka ndërkomunale. Kur do të ndërrojë kjo, pse po vazhdon kështu?

Qëndron Kastrati ngriti çështjen e moskthimit të përgjigjeve nga ana e ekzekutivit. Ai pyeti se pse ekzekutivi nuk na ka sjellur raportin për Bibliotekën, që e kemi ngritur ne si grup, ka diku 4-5 mbledhje, nuk e di saktë, por neve ende nuk na është sjellur pika të cilën e kemi ngritur.

Të paktën, a ka mundësi të na përgjigjeni se ku janë problemet, ku janë vështirësitë që po haset me u përpiluar raporti ose kur do të sillen raportit?

Kimet Zeqa, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Përball Stacionit të Policisë, i ashtuquajtur 92-shi, që është oborri andej, nuk ka mundësi me kaluar me automjet në rast urgjent. Aty bllokohet rruga, deri kur do të bëhet me kartela me hy, se është ajo lagje e banorëve. Aty parkohen veturat e personave që hyjnë në kafiteri, dhe ata të Maqedonisë. Këtë problem e kam cekur edhe me parë dhe deri më tani nuk kam marr asnjë përgjigje.

Naime Osmani, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Nuk kam informata për rrjetin e kanalizimit në Besi, konkretisht në Lagjen e Bllacajve. Kërkoj të di se a do të kyçen në këtë rrjet kanalizimi familjet Marolli, Megjuani dhe Prebreza. Më pas edhe për rrjetin e ndriçimit, që është shpallur tenderi dhe nuk e dimë ende a ka përfitues apo është anuluar ai tender për fshatin Besi, si dhe një rrugë është ndërtuar në Besi, rrugë pa krye, mirëpo nuk e kanë vazhduar për disa metra, që t'i mundësohet një fermeri rregullimi i infrastrukturës që ta zhvillojë biznesin e tij.

Po ashtu një kërkesë për Grupin e grave: Komiteti i grave të verbëra, më 15.6.2015, kishte një takim me Grupin e grave të Kuvendit të Komune së Prishtinës. Ky komitet ndihet thellë i indinjuar dhe, në njërën anë i diskriminuar, pas të gjitha kërkesave që i kanë paraqitur Kryetarit të Komunës, sidomos janë ndër të diskriminuara më 1 Qershor, kur Kryetari i Komunës nuk ka marr kurrfarë aktiviteti për fëmijët e verbër.

Kërkesat e këtij komiteti janë: që t'iu mundësohet transporti urban pa pagesë të verbërve, kuptohet në bazë të librezave që i kanë, po ashtu t'iu lëshohet vendimi për objektin të cilin e shfrytëzojnë, meqë në mandatin e kaluar Kryetari i Komunës, z. Isa Mustafa, ua ka lëshuar objektin që është në rrugën "Gazmend Zajmi" në lagjen "Kodra e Diellit", dhe ato kërkojnë që ta kenë vendimin që ta shfrytëzojnë atë objekt të përhershëm.

Po ashtu t'iu sigurohet transporti i nxënësve të verbër të komunës së Prishtinës, t'iu sigurohet transporti nxënësve të verbër të cilët vijnë shkollimin në Pejë, meqë atje kanë qëndrim javor, ato do të na e sjellin numrin e nxënësve dhe Komuna mundësisht ta sigurojë transportin.

Lirijeta Rexhepi shtroi tri çështje për diskutim.

E para, ka të bëjë me qendrën tregtare "Lesna", që është në lagjen "Kodra e Diellit".

Kush e menaxhon pjesën që është në menaxhim, d.m.th. pjesa e përgjithshme e qendrës, jo ato lokale që janë private. Ka filluar me u shkatërruar një pjesë e objektit, ku pronarët e atyre lokaleve po kanë shumë probleme.

E dyta, është ajo që e pata shtruar disa mbledhje radhazi, ajo për ndërrimin e gypave në atë projektin që e ka përfshi edhe lagjen “Velania”. Projekti ka përfunduar, por ka mbetur që rrugës t’i shtrohet edhe një shtresë e asfaltit.

E treta, ka te bëj me ndriçimin përreth Bibliotekës Kombëtare. Kërkoj që sa më parë të bëhet ndriçimi i hapësirës përreth Bibliotekës.

Muhamet Selmani, pyetje për Drejtorinë e Arsimit.

Kërkoj që të sillen dëshmitë apo raportet e vlerësimit për zgjedhjen e drejtorit në shkollën fillore “Ali Kelmendi” në Barilevë, si ka ecur procesi, si është votuar dhe si janë poentuar të gjithë kandidatët.

Pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Përse është vonuar projekti për fillimin e asfaltimit të rrugës nga shkolla fillore “Ali Kelmendi”, që e lidh me Besinë dhe kanalizimet përreth.

Deri ku ka mbërri projekti për rregullimin e kanalizimit të lagjes “Prugovci 1”, që është së bashku me gypat që kanë qenë për rrjedhën e ujit atmosferik që vijnë nga Truda dhe Bardhoshi.

Pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Si ka rrjedhur ecuria e projektit për grumbullimin e perimeve dhe pemëve, që ka qenë në atë parcelën e tokës që është në Prugovc, në udhëkryqin me Barilevën.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Selmani, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, dha sqarime të nevojshme.

Lirije Avdiu ngriti një shqetsim rreth pikës - Pyetje dhe përgjigje, e cila tha se dërisa drejtorët nuk janë të pranishëm kur diskutohet në këtë pikë, pyetjet nuk do t’i parashtrujmë.

Shemsi Veseli ngriti shqetësim rreth një vendimi, duke thënë se në këtë Kuvend është marr një vendim (jo nga kjo përbërje), që ka qenë për një kardiokirurgji, e nuk ka qenë për një spital të përgjithshëm. Kisha pasur dëshirë që për mbledhjen e radhës, të më jepet një përgjigje se pse nuk po merr masa Kuvendi i Komunës në raport me atë, kur e dinë që me ligj nuk ka të drejtë të ndryshohet pronari prej pronarit pa kaluar në Kuvendin komunal ai vendim, për arsye se toka është e Komunës dhe ajo tokë nuk mundet të jepet në shfrytëzim pa u marr një vendim i tillë këtu në Kuvendin e Komunës.

Islam Pacolli, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Është një kërkesë urgjente për çështjen e rrugës, që nuk po marr përgjigje. Ajo është një kërkesë që i bëj edhe Kryetarit të Komunës, edhe nënkryetarit, si dhe drejtorit të Infrastrukturës, që të merren me atë çështje, se ajo rrugë është bërë e pakalueshme, e padurueshme, me pluhur, baltë etj. Derisa edhe pusetat e kanalizimit, disa prej tyre që janë kyçur, janë mbetur të hapura, dhe ka mundësi edhe me u infektuar dikush.

Po ashtu pyes rreth një problemi që ka pasur një qytetar afër objektit të çerdhes dhe kërkoj të di se a është marr ndonjë vendim që ai qytetar të ket qasje në rrugë.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Veseli, z. Pacolli dhe z. Krasniqi, **Visar Berisha,** drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, dha sqarime te nevojshme.

Mbledhja mbaroi në orën 14:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.

Faqe 8 nga 8